



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1058/5 Prot.

Tiranë, më 6/12/2013

URDHËR

Nr. 24, datë 06/12/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit mbi kontrollin administrativ të ushtruar pranë kontrolluesit "Plus Communication" sh.a.

KONSTATOVA

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëpërmjet grupit të kontrollit administrativ të Drejtorisë Hetim Inspektimit, ka kryer kontroll administrativ pranë kontrolluesit Plus Communication sh.a, operator i telefonisë celulare në Shqipëri, i cili gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike, mbledh dhe përpunon të dhëna personale.

Objekti i kontrollit administrativ:

- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale.
- Si zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.
- Si evidentohen dhe zbatohen Udhëzimet e Vendimet e Komisionerit.
- Kategoria e mjeteve të përpunimit që përdoren konformë kushteve dhe kriterëve të dispozitave të mësipërme.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi aktet e kontrollit administrativ të mbajtura nga grupi që ushtroi kontrollin administrativ (procesverbalin e konstatimit të shkeljeve, relacionin e kontrollit administrativ etj) si dhe provat e administruara vëren se:

Gjatë kontrollit administrativ u konstatua se:

1. Kontrolluesi Plus Communication sh.a ruan dhe administron në mënyrë elektronike në tape (kasete), skedarët e klientëve CDR (tabulatet e komunikimit) të cilat mbartin të dhëna personale nga fillimi i aktiviteti të këtij kontrolluesi (Shtator 2010).
2. Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit (CCTV) në ambiente ku zhvillon aktivitetin e tij:
 - Zyra të punonjësve si billing, controll room, call center, zyra të hapura etj.
 - Kamerat e vendosura në disa prej zyrave të monitoruara me sistem CCTV janë të kategorisë “Spedom” (kanë akses zmadhimi, zvogëlim dhe rrotulluese).
 - Kamera të vendosura në ambiente të jashtme të godinës, janë të kategorisë “Spedom” (kanë akses zmadhimi, zvogëlim dhe rrotulluese), të cilat kanë një rreze vëzhgimi/monitorimi përtej territorit të godinave të kontrolluesit.
3. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregulla dhe politikë të qartë për këtë kategori mbledhje dhe përpunim të dhënash personale nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV) në funksion të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme” (i ndryshuar).
4. Nuk konstatohet informim i qartë dhe i shprehur nga ana e kontrolluesit për subjektet e të dhënave personale punonjës lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV.

Në këto raste;

- a) Sa i përket ruajtjes dhe administrimit në mënyrë elektronike të skedarëve të klientëve (CDR, tabulatet e komunikimit), kontrolluesi konsiderohet në shkelje të nenit 5 pika1/d i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... “Në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”, nenit 27/4 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar)... “Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është e nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar”.
- b) Mbledhja dhe përpunimi i të dhënës imazh-video nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV) duke përdorur kamera me aftësi zmadhimi, zvogëlimi dhe rrotullim, në ambientet e zyrave të punonjësve si dhe monitorimi përtej territorit/ambienteve të kontrolluesit konsiderohet jo në përputhje me qëllimin e shprehur në “politikën e sigurisë fizike” të kontrolluesit “Plus Communication”, mosrespektim të nenit 5 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
 - Mungesa e rregullores së shkruar specifikisht për mbledhjen dhe përpunimi në të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV konsiderohet shkelje e nenit 27/1 të

ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”...”Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”..., si dhe udhëzimi nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”(i ndryshuar).

- Informimi i subjekteve të të dhënave personale për kategorinë punonjës, për monitorimin nëpërmjet sistemit CCTV në ambientin e punës vetëm nëpërmjet tabelës informuese në hyrje të ndërtesës së kontrolluesit konsiderohet jo i mjaftueshëm dhe në mosrespektim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Duke marrë në konsideratë konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, reagimin e menjëhershëm dhe masat paraprake të marra nga kontrolluesi “Plus Comunication” sh.a, lidhur me eliminimin e shkeljeve të konstatuara vlerësoj se; sa i përket shkatërrimit të të dhënave të administruara në mënyrë elektronike në tape (kaseta), skedarët e klientëve CDR (tabulatet e komunikimit), është i mjaftueshëm një afat 3-muaj.

Gjithashtu në kuadrin e masave që kontrolluesi “Plus Comunication” sh.a ka marrë në aspektin e mbrojtjes së privatësisë, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, duhet që në faqen tuaj të internetit të vendosen “politika privatësie” që referojnë me ligjin nr.9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me qëllim ndërgjegjësim masiv të subjekteve të të dhënave personale që vizitojnë faqen tuaj në internet.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

U R D H Ë R O J:

1. Në mbështetje të neneve 5 pika1/d, 27/4 të i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të bëhet shkatërrimi i të dhënave personale që ruhen dhe administron në mënyrë elektronike (në sisteme) dhe në kaseta (tape), skedarët e klientëve (tabulatet e komunikimit), të cilët kanë plotësuar afatin mbi dy vjet.
2. Në mbështetje të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në faqen tuaj të internetit të vendosen “politika privatësie” që referojnë me ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

3. Kryerja e detyrave të lëna në këtë Urdhër, të realizohet deri në datën 31 Mars 2014 .
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mospërbushje të detyrave të lëna në këtë urdhër, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

